



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2 dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim ka këto karakteristika:**
1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 01673-1, me sipërfaqe 205 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01673-1, Zona Kadastrale Prishtinë, në pronësi të P.SH. Rrugët dhe pjesa e parcelës kadastrale, nr. 01674-0, me sipërfaqe 205 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01674-0, Zona Kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 035-186861, të dt. 2.10.2013.
 2. Kurse pronat e paluajtshme që merren nga ky këmbim, janë parcelat kadastrale nr. 01660-41, me sipërfaqe 205 m², Zona Kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01660-41, në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit, dhe parcela kadastrale 01654-41 me sipërfaqe 205 m², Zona Kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01654-41, në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Jahi (Mejdi) Ramadanit, me destinim rrugë e planifikuar sipas Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, i miratuar me vendimin nr. 01, nr. 035-186861, dt. 2.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër”, i miratuar me vendimin nr. 01, nr. 035-186861, dt. 2.10.2013.**
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.**

- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- Skica grafike,
 - Kopjet e planit dhe
 - Certifikata e njësisë kadastrale.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-204124/23, më 10.10.2023

KRYESUESI KEVEJNDIT
Pëllumb Bajriçevci



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05 nr.350/02-0176987/21, dt. 27.10.2022, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 01673-1 me sipërfaqe 205 m² dhe 01674-0 me sipërfaqe 205 m², Z.K Prishtinë në pronësi të P.Sh Rrugët dhe Komuna e Prishtinës, të cilat gjenden në kuadër të bllokut urban "A-16" tërësia "A", Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr. 035-186861 dt. 2.10.2013 dhe parcelat kadastrale me nr. 01660-41, me sipërfaqe 205 m² dhe 01654-41 me sipërfaqe 205 m², Z.K Prishtinë, në pronësi të Afrim (Zenel) Memetit, Jakup (Ejup) Ismailit, Bajram (Ibish) Gashit dhe Jahi (Mejdi) Ramadanit, me destinim rrugë të planifikuar.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013. Pjesët e parcelave me nr. 01673-1 dhe 01674-0 Zona Kadastrale Prishtinë shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa parcelat me nr. 01660-41 me sipërfaqe 205 m² dhe 1654-41 me sipërfaqe 205 m², Z.K Prishtinë, sipas Planit rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", i miratuar me vendimin nr. 01 nr.035-186861, dt. 2.10.2013, shtrihen në infrastrukturë publike - rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.